Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe, si dhe investime.

Realizimi i shpenzimeve nga transferta e kushtëzuar është 670,017 mijë lekë ose 97 % .


Art.	Emertimi	(1)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
		i vitit paraardhës Viti 2020	Plan Fillestar Viti 2021	Plan i Rishikuar Viti 2021	Janar -Dhjetor 2021	
600	Paga	5,077,107	5,157,000	7,262,000	7,219,593	-42,407
601	Sigurime Shoqërore	803,075	870,000	870,000	856,090	-13,910
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	84,000	60,000	294,000	290,000	-4,000
603	Subvencione	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	895,850	0	2,473,781	2,473,781	0
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	588,613,578	591,783,600	605,728,840	597,642,973	-8,085,867
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	595,473,610	597,870,600	616,628,621	608,482,437	-8,146,184
230	Kapitale të Patrupëzuara					0
231	Kapitale të Trupëzuara	140,327,267	0	72,313,898	61,534,356	-10,779,542
232	Transferta Kapitale					0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	140,327,267	0	72,313,898	61,534,356	-10,779,542
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti					0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		735,800,877	597,870,600	688,942,519	670,016,793	-18,925,726

Emertimi	Plani vjetor	Fakti	Diferencë	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	8,132	8,076	56	99 %
Shpenz.Operative	294	290	4	99 %
Transferime	608,203	600,117	8,086	98 %
Investime	72,314	61,534	10,780	85 %
Totali	688,943	670,017	18,926	97 %

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e kushtëzuar në total është 97% .Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në masën 99 % ,transfertat me 98 % dhe investimet 85% .

Në transfertën e kushtëzuar , peshën më të madhe specifike e zënë transferimet kryesisht fondi i ardhur për pagesën e ndihmës ekonomike, paaftësisë dhe invaliditeti.

Paraqitja grafike e shpenzimeve nga transferta e kushtëzuar.



VIII. DETYRIMET NDAJ TË TRETËVE SIPAS VJETËRSISË SË TYRE, SITUATA FINANCIAR E NORMALE DHE RASTET E VËSHTIRËSIVE FINANCIARE

Janar -Dhjetor 2021

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	11,078,051		1.56%
a	Shpenzime korrente	0		
a,1	Mallra dhe shërbime			
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	10,778,051		
b,1	Insitucione buxhetore	10,778,051		
b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	300,000		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime	300,000		
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	11,078,051	711,891,427	1.56%

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore				
Situata Normale e gjendjes fiannciare	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Paaftësi paguese
	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%
Situat Normale e gjendjes financiare	0	0	0	0

VIII. 1 Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan)
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	141,213,000	161,133,000
1	Taksat e veta vendore	28,806,000	38,708,000
a.	Taksa mbi pasurinë	11,967,000	18,458,000
b.	Biznesi i vogël	1,640,000	500,000
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6,151,000	13,000,000
d.	Taksa të tjera vendore	9,048,000	6,750,000
2	Të ardhura jotatimore	92,556,000	101,337,000
a.	Tarifat e shërbimeve publike	81,928,000	23,028,000
b.	Tarifa administrative	1,125,000	4,600,000

c.	Të tjera jo tatimore	9,503,000	73,709,000
3	Taksa të ndara	19,851,000	21,088,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	758,000	500,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	10,257,000	8,600,000
c.	Renta minerare	357,000	100,000
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	8,479,000	11,888,000
e.	Të tjera		
II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	1,254,916,464	1,399,700,121
1	Shpenzime Korrente	1,011,956,939	1,108,619,568
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	215,568,230	244,517,530
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	35,332,815	41,418,179
d.	Shpenzime Operative	139,277,413	181,290,411
e.	Të tjera korrente	621,778,481	641,393,448
2	Shpenzime Kapitale	242,959,525	291,080,553
3	Burimet e Financimit	1,254,916,464	1,399,700,121
a.	Të ardhurat e veta vendore	133,079,614	187,510,376
b.	Transferta e pakushtezuar	306,864,084	363,190,355
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale	144,955,973	161,190,696
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)	670,016,793	687,808,694

VIII.2 Detyrimet për periudhën Janar- Dhjetor 2021 janë 11,078 mijë lekë.

Nr.	Bashkia	Detyrimi i mbetur deri në Dhjetor 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Diferencë (Fakt-Plan)	Shenime
	Bashkia Librazhd					0	
1	Mbikqyrje punimesh "Furnizim me uje I fshatrave Dorez,Gizavesh ,Librazhd Katund ,Librazhd Qender	479,206	479,206				Burim financimi buxheti shtetit ,ne pritje te fondeve
4	Kolaudim Rikonstruksion I oborrit dhe punimeve ne hollin e shkolles se mesme I.Muca	13,200	13,200				Proces likujdimi
7	Mbikqyrje "Rikonstruksion I rrugeve te brendeshme te fshatrave te komunes viti 2014 ish Komuna Hotolisht	23,400	23,400				Detyrim I trasheguar nga ish komunitat ,krijuar per mungese dokumentacioni
8	Vendime Gjyqesore	300,000	300,000				
	Blerje materiale shtrim I rrugeve rurale me inerte	300,150	300,150				Investim me dy faza , prere fatura e 2022
	Rikonstruksion ne kanale vaditese (kanali Joletes ,kanali Taksimi Gjures Kuterman, kanali Vijha e vogel dardhe ,vija e gurit Prevalle.	2,114,660	2,114,660				Investim me dy faza , prere fatura e 2022
	Rikonstruksion i kanalit vadites te Mesit ,Gizavesh,Dorez,Librazhd	7,372,724	7,372,724				Investim me buxhetin e shtetit ,Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit rural
	Rehabilitim, perforcim banesash ekzistuese dhe rikonstruksion qendra e fshatit Toge	474,711	474,711				
		11,078,051	11,078,051	0	0	0	

Investimet e mëposhtëme janë Detyrime nga FZHR të cilat janë deklaruar në Degën e Thesarit .

Rikualifikimi urban Zona Perendimore te Qytetit Librazhd ,Prita lumore	8,534,111	Proces gjyqesore , per shkelje afateve , burim financimi FZHR
Kolaudim "Rikonstrukcion I rruges automobilistike Dardhe ish Komuna Hotolisht	166,536	Detyrim I trasheguar nga ish komunat, Investim nga FZHR
Totali	8,700,647	

Në total detyriet për vitin 2021 të cilat trashëgohen në vitin 2022 janë 19,778,698 lekë .

FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Nënfunkcioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme

Programi 01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. Gjendja Civile

Realizimi i qëllimeve dhe objektivave të politikës së programit

Qëllimi i programit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është:

- I. Strukturë menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për përthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë Librazhd për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
- II. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.
- III. Dixhitalizmi i administratës publike do të jetë gjithmonë një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore. Shtimi dhe promovimi i shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore ku qytetarët të kenë mundësinë që të aplikojnë dhe përfitojnë shërbimin në çdo Njësi Administrative, dhe përmes Web-it për të gjitha shërbimet që sot ofrohen nga Bashkia e Librazhdit.

Objektivat e programit buxhetor për vitin 2021 kanë qenë:

- O1. Organe përfaqësuese vendore të mbështetura për funksionimin e tyre.
- O2. Burime Njerëzore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.
- O3. Shërbimet mbështetëse për administratën vendore siguri planifikimi e zhvillimi të njësisë, menaxhimin e financave të administratës vendore dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun.
- O4. Përbushje detyrimesh për ndjekje dhe përfaqësim procese gjyqësore, shlyerje e detyrimeve që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formës së prerë.

Rezultatet e programit “ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”


000/leke

Programi P01110	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 2021	95,514	36,000	8,999	28,424	168,937
Realizimi 2021	84,549	28,901	6,425	14,209	134,084
Diferencë	10,965	7,099	2,574	14,215	34,853
Realizimi në %	88 %	80 %	71 %	50 %	79 %

Realizimi i programit Planifikim, Menaxhim dhe Administrim në total është 79 % konkretisht :

- shpenzime për paga dhe sigurime është realizuar në masën 88 %.
- shpenzimet operative janë realizuar në masën 80 %.
- shpenzime për transferta janë realizuar 71 %.
- shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 50 %.

Pesha specifike që zë secili shpenzim



❖ Detajimi i shpenzimeve operative për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” 1110

Shpenzimet operative janë realizuar me 80 % kjo për shkak të disa kontratave të cilat janë lidhur në fund të vitit dhe nuk janë realizuar, si dhe kontrata të cilat e kanë shtrirjen e afateve deri në vitin 2022 , konkretisht është :

- Blerje goma + pjesë xhenerike, mirëmbajtje mjeteve kontrata përfundon në tetor 2022
- Shërbim e mirëmbajtje Programit të Financës dhe Taksave Vendore, është prokuruar vetëm pjesa programit të taksave vendore .
- Blerje kartolina e kalendar, Blerje fishek zjarre.
- Materiale promovuese për turizmin pa prokuruar.
- Udhëtime e dieta jashtë vendit nuk janë realizuar.
- Kontribut i shoqatës së Bashkive pa realizuar.

Nr.	EMERTIMI I SHPENZIMEVE	Kap	Plani vjetor	Shtesa	Pakësime	Plani me ndryshime 2021	Fakti 2021
1	Shpenzime për energji për Bashkinë dhe Njësite ,Ndricimi rrugor+ lidhje të reja	1	10,000,000			10,000,000	8,089,232
2	Shpenzime për ujësjellësin	1	350,000			350,000	263,163
3	Shpenzime për internetin	1	700,000		55,000	645,000	567,499
4	Shpenzime telefonike	1	400,000			400,000	92,688
5	Blerje Shtypshkrime	1	1,000,000		876,794	123,206	106,800
6	Blerje Kancelari	1	1,200,000			1,200,000	1,199,221
7	Siguracion ndërtesash	1	500,000			500,000	499,000
8	Taksa e mjeteve të Bashkisë	1	100,000	1,200,000		1,300,000	1,183,730
9	Siguracion makinash	1	320,000			320,000	89,106
10	Shpenzime për postën	1	2,100,000			2,100,000	1,998,382
11	Udhëtime e dieta jashtë vendit	1	700,000			700,000	69,216
12	Udhëtime e dieta brenda vendit	1	500,000			500,000	414,963
13	Regjistrim i pasurive në ZRVP të tjera mardh me inst shtetërore	1	1,500,000			1,500,000	1,142,780
14	Barrë hipotekore dhe sekuestro mbi pasuritë e paluajtshme	1	50,000			50,000	50,000
15	Shpenzime për Këshilltarë + Kryepaq	1	6,151,000			6,151,000	5,864,380
16	Egzekutim Vendime Gjyqësore	1	5,000,000		4,551,003	448,997	448,997

17	Blerje Karburant	1	1,900,000			1,900,000	1,373,112
18	Blerje goma + pjesë xhenerike,mirëmbajtje mjetesh	1	1,000,000			1,000,000	687,550
19	Kontribut i shoqatës së Bashkive	1	450,000			450,000	-
20	Larje e automjeteve të Bashkisë	1	100,000			100,000	96,000
21	Blerje kartolina e kalendar	1	200,000			200,000	-
22	Blerje fishek zjarre	1	200,000			200,000	-
23	Shpenzime pritje përcjellje + dhurata me simbolet e bashkisë	1	300,000			300,000	130,300
24	Hostimi i faqes internetit	1	50,000			50,000	41,000
25	Materiale promovuese për turizmin	1	250,000			250,000	-
26	Panairi "Festa e mjaltit "	1	850,000			850,000	719,880
27	Shërbim e mirëmbajtje Programit të Financës dhe Taksave Vendore	1	1,000,000			1,000,000	158,000
28	Blerje gazeta	1	20,000			20,000	-
29	Domain faqja zyrtare e Bashkise			5,000		5,000	5,000
30	Blerje fshese mekovent			55,000		55,000	55,000
	Të trashëguarat nga viti 2020						-
1	Trasmentimi i njoftimeve ne mediat audiovizive per vitin 2020	1	400,000			400,000	400,000
2	Sherbime e mirembajtje per paisjet elektronike ,kamerat e sigurise	1	489,000			489,000	489,000

3	Blerje pjese kembimi per mjetin Nisan Terrano AA308EO dhe riparim defekti te paparashikuar per mjetin Zjarrfikes tip Benz te MZSH Bashkia Librazhd	1	204,700			204,700	204,700
4	Blerje fishekzjarre	1	295,200			295,200	295,200
5	Sherbim postar	1	248,975			248,975	248,975
6	Blerje gazeta	1	7,330			7,330	-
7	Blerje kalendar e kartolina	1	98,500			98,500	98,500
8	Ekzekutim vendime gjyqesore	1	1,468,874			1,468,874	1,468,799
9	Shpenzime telefoni	1	301,448			301,448	5,200
10	Blerje ngrohes elektrik	1	30,000			30,000	13,000
11	Drenazhim rreshqitja rrapun						137,454
	Shpenzime aktivite/e-civile V.Blloku						195,100
TOTALI I SHPENZIMEVE			40,435,027	1,260,000	5,482,797	36,212,230	28,900,927

❖ *Realizimi i investimeve për programin "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"*

Shpenzimet kapitale janë realizuar me 50 % kjo për shkak të disa kontratave të cilat nuk janë realizuar dhe konkretisht është :

- Mbikqyrje kolaudime nuk janë realizuar për shkak të mos përfundimit të kontratave ose neglizhenca e operatorëve fitues të cilët nuk presin faturat.
- Studime projekte për vitin 2021 pa prokuruar .
- Blerje paisje profesionale per kuzhinat e kopshteve pa prokuruar .
- Blerje mobilie te ndryshme per zyrat e Bashkise Librazhd pa prokuruar .
- Detyrime te prapambetura është fond i ardhur nga buxheti i shtetit për likuidimet e detyrimeve më të vona që ka bashkia ,miratuar në këshillin Bashkiak ,në pritje të konfirmimit.

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2021	Realizimi Janar-Dhjetor 2021	Komente
01110	Planifikim Menaxhim Administrimi	50,611,690			24,647,582	28,423,861	14,209,318	
1	Bashkefinancim Permisimi i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara	8,823,846	2020	2021	8,823,846	4,823,846	4,582,654	Investim I perfunduar ,marre ne dorezim ,likujduar
3	Azhornim per regjistrim fillestar te zones kadastrale te fshatit Qarrisht , Nj.Qender	2,454,912	2018	2018	736,474	736,474		Mbajtje penaliteti
4	Kolaudim " Rikonstruksion I pjesshem shkolla 9-vjecare Vehcan Nj.Hotolisht	27,582	2019	2019	27,582	27,582		Ne proces
5	Kolaudim " Ndertim ujesjellesi Hotolisht fshat dhe fshati Merqize ,lagja Spathar Nj.Qender	198,000	2019	2019	198,000	198,000		Ne proces
6	Mbikqyrje " Rikonstruksion I kanalit vadites Gurakuq-Kuterman (loti i I ndertim I sifonit te madh	370,028	2019	2019	370,028	370,028	308,356	Perfunduar ,likujduar(dif. Kaluar biznes pa tvsh)
7	Instalimi I programit te finances dhe kontabilitetit per D.m. financiar dhe zhvillimi ekonomik	72,000				72,000		Ne proces
8	Kolaudim " Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Orenje	11,234				11,234		Ne proces
9	Mbikqyrje " Rikonstruksion kanali vadites Orenje- Floq (degezimi kanalit Gurakuq kuterman	163,020				163,020		Ne proces
10	Kolaudim " Riparim lere betoni dhe plasmasi .	7,800	2020	2020	7,800	7,800		Ne proces
11	Kolaudim "Ndertim ure tip beli mbi lumin Shkumbin Rrethi Bardhe	27,000	2020	2020	27,000	27,000		Ne proces
12	Kolaudim " Ndertim vepra rugore dhe ujore ne Njesite Administrative te Bashkise "	20,400	2020	2020	20,400	20,400		Ne proces
13	Mbikqyrje Rikonstruksion I rruges se fshatit Hotolisht dhe kthesa Xhyre	202,500	2020	2020	164,095	164,095		Ne proces
14	Mbikqyrje "Rikonstruksion rruge rurale dhe hapje traste ne rrugen e lagjes Roci-Bogdani"	48,000	2020	2020	48,000	48,000	48,000	Perfunduar ,likujduar
15	Mbikqyrje "Rikonstruksion i kanalit vadites te Mesit ,Gizavesh,Dorez,Librazhd "	1,293,836	2020	2020	794,736	794,736		Ne proces
16	Mbikqyrje "Rikonstruksion dhe Rehabilitim I Pallatit te Kultures ne Librazhd"	663,810	2020	2020	590,680	590,680	590,680	Perfunduar ,likujduar
17	Mbikqyrje Permisimi I banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara	574,652	2020	2020	468,215	468,215	468,215	Perfunduar ,likujduar

18	Kolaudim "Riparime te pjeshme emergjente ne kanalet vaditese 2020"	3,170	2020	2020	3,170	3,170		Ne proces
19	Mbikqyrje Ndertim prite gjatesore fshati Xhyre ,vazhdim	139,747	2020	2020	139,747	139,747	139,747	Perfunduar ,likujduar
20	Mbikqyrje Rikonstruksion dhe shtim prurje ne ujesjellesin Letem ,Njesia Lunik	60,000	2020	2020	60,000	60,000	60,000	Perfunduar ,likujduar
21	Mbikqyrje Shtese Kontrate Rikonstruksion I rruges se fshatit Hotolisht dhe Kthesa e Xhyres ,Nj.Hotolisht	26,400	2020	2020	26,400	26,400		Ne proces
22	Kolaudim Rikonstruksion I oborrit dhe punimeve ne hollin e shkolles se mesme I.Muca	13,200	2020	2020	13,200	13,200		Ne proces
23	Kolaudim Ndertim prite gjatesore fshati Xhyre,Vazhdim	21,600	2020	2020	21,600	21,600	21,600	Perfunduar ,likujduar
24	Kolaudim Rikonstruksion dhe shtim prurje ne ujesjellesin Letem ,Njesia Lunik	9,000	2020	2020	9,000	9,000	9,000	Perfunduar ,likujduar
25	Kolaudim "Permisimi I banesave per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara"	60,000	2020	2020	60,000	60,000	60,000	Perfunduar ,likujduar
26	Kolaudim Rikonstruksion I kanaleve vaditese ne Bashkine Librazhd per vitin 2019	44,400				44,400		Ne proces
27	Studim Projektim "Ndertim I ujesjellesit te fshatrave Polis-Gureshpate, Polis Qender ,Polis - Gostime etj	960,000	2020	2021		960,000	935,194	Perfunduar likujduar(vlera 15,206 penalitete per zbatim afati)
28	Studim projektim (Loti II (objekte te ndryshme)	3,902,423	2020	2021		3,785,350	3,724,784	Perfunduar likujduar(vlera 60,566 penalitete per zbatim afati)
29	Studime projektme	4,000,000	2021	2021		4,000,000		Pa prokuruar
30	Blerje paisje profesionale per kuzhinat e kopshteve	780,000	2021	2021		780,000		Pa prokuruar
31	Blerje paisje elektronike	500,000	2021	2021		500,000	389,000	Perfunduar ,likujduar
32	Blerje mobilie te ndryshme per zyrtar e Bashkise Librazhd	500,000	2021	2021		500,000		Pa prokuruar
33	Kolaudim Shtese Kontrate Rikonstruksion I rruges se fshatit Hotolisht dhe kthesa e Xhyres Nj.Adm Hotolisht	3,600	2021	2021		3,600		Ne proces
34	Kolaudim Rikonstruksion I rruges se fshatit Hotolisht dhe kthesa e Xhyres Nj.Adm Hotolisht	21,600	2021	2021		21,600		Ne proces
35	Kolaudim Rikonstruksion rruge rurale dhe hapje traste ne rrugen e lagjes Roci-Bogdani	6,480	2021	2021	6,480	6,480	6,480	Perfunduar ,likujduar
36	Mbikqyrje Ndertim kalimi emergjent te perroi Murrash ,me strukture betoni (Hd=3M) fshati Arrez	75,600	2021	2021	75,600	75,600	75,600	Perfunduar ,likujduar
37	Mbikqyrje Rikonstruksion I kanali Rine Dorez, Librazhd	414,918	2021	2021	383,002	383,002	383,002	Perfunduar ,likujduar
38	Mbikqyrje Ndertim Miniparku I qytetit prane argjinatures se lumit Shkumbin (Faza II dhe Faza III)	389,972	2021	2021	302,902	302,902	302,902	Perfunduar ,likujduar
39	Mbikqyrje punime emergjente per venien ne funksion te rruges se	98,400	2021	2021	98,400	98,400	98,400	Perfunduar ,likujduar

	lagjes Lala ,Letem Nj.Lunik							
40	Kolaudim "Ndertim Kalimi emergjent te perroi Murrash me strukture betoni (Hd=3M) fshati Arrez	11,400	2021	2021	11,400	11,400	11,400	Perfunduar ,likujduar
41	Kolaudim "Punime emergjente per venien ne funksion te rruges se lagjes Lala Letem Njesia Adm.Lunik	6,658	2021	2021	6,658	6,658	6,658	Perfunduar ,likujduar
42	Mbikqyrje Rikonstruksion I rrugeve rurale dhe veprave te artit te Bashkise Librazhd	183,425	2021	2021	183,425	183,425	183,425	Perfunduar ,likujduar
43	Mbikqyrje kolaudime per vitin 2021	1,554,650	2021	2021		687,099		Ne proces
44	Mbikqyrje "Ndertim shkolla 9-vjecare vartese Sebishte Nj.Adm Stebleve	48,000	2021	2021		48,000	40,000	Perfunduar ,likujduar
45	Mbikqyrje "Rehabilitim I shesheve ne qender te fshatit Toge Nj.Adm Qender,fshati Floq Nj.Adm.Orenje	191,970	2021	2021	191,970	191,970	191,970	Perfunduar ,likujduar
46	Kolaudim "Rikonstruksion dhe rehabilitim I pallatit te kultures ne Librazhd	72,000	2021	2021		72,000		Ne proces
47	Mbikqyrje "Punime per nderhyrje dhe riparime te detyruara ne rruget rurale te demtuara nga rreshqitjet"	34,800	2021	2021		34,800	34,800	Perfunduar ,likujduar
48	Mbikqyrje "Ndertim ure dhe punime mbrojtje rruge ,toke dhe objektesh te demtuara nga rreshqitjet dhe reshjet"	145,240	2021	2021	145,240	145,240	145,240	Perfunduar ,likujduar
49	Mbikqyrje "Rikonstruksion ne kanalet vaditese (kanali Joles Poliss,kanali Taksimit Gjures Kuterman,kanali vija e vogel Dardhe,Vija e Gurit Prevalle"	205,920	2021	2021	205,920	205,920	205,920	Perfunduar ,likujduar
50	Mbikqyrje "Riparime te pjeseshme ne kanalet vaditese	93,600	2021	2021	93,600	93,600	78,000	Perfunduar ,likujduar(dif. Kaluar biznes pa tvsh)
51	Kolaudim "Rikonstruksion I rrugeve rurale dhe veprave te artit	22,020	2021	2021	22,020	22,020	22,020	Perfunduar ,likujduar
52	Mbikqyrje Ndertim Central Park (parku Qendror)	660,133	2021	2021		660,133		Ne proces
53	Kolaudim "Punime per nderhyrje dhe riparime te detyruara ne rruget rurale te demtuara nga rreshqitjet	4,200	2021	2021		4,200		Ne proces
54	Shtese fondi sipas vkb nr.46 date 28.05.2021 "Blerje mjet tip fouristrade 4x4 per administraten e bashkise	5,520,000	2021	2021				Pakesuar
55	Kolaudim Ndertim ure dhe punime mbrojtje rruge ,toke dhe objektesh te demtuara nga rreshqitjet dhe reshjet	16,560	2021	2021	16,560	16,560	16,560	Perfunduar ,likujduar
56	Kolaudim "Rikonstruksion ne kanalet vaditese (kanali Joles Poliss,kanali Taksimit Gjures Kuterman,kanali vija e vogel Dardhe,Vija e Gurit Prevalle"	30,960	2021	2021	30,960	30,960	30,960	Perfunduar ,likujduar
57	Kolaudim Rehabilitim I shesheve ne qender te fshatit togez ,Nj.Adm Qender dhe fshati Floq Nj.Adm.Orenje	19,920	2021	2021	19,920	19,920	19,920	Perfunduar ,likujduar
58	Kolaudim Rikonstruksion kanali Rine Dorez Librazhd	57,600	2021	2021	57,600	57,600	57,600	Perfunduar ,likujduar

59	Permisimi i banesave ekzistuese per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuara per vitin 2021	8,311,197	2021	2022	8,311,197	3,740,040	917,254	Proces likujdimi
60	Kolaudim Riparime te pjeseshme ne kanalet vaditese kanali rezervuarit Vehcan,kanali Gurre Mushane Zdrajsh katund,kanali Orenje-Floq kanali Zabzun,Gostim,Mirake Sifoni Zgosht kanali dishes Stebleve,Gurra e Zeze Xhyre,kamine Xhyre,kanali Vija e re Prevalle kanali Staravec Vulcan,kanali Vertop-Zabeli Kokreve	13,978	2021	2021	13,978	13,978	13,977	Perfunduar ,likujduar
61	Kolaudim Ndertim Miniparku I qytetit prane argjinatures se lumit Shkumbin (Faza II dhe Faza III)	36,000	2021	2021	36,000	36,000	30,000	Perfunduar ,likujduar
62	Blerje dhe montim kondicioner kollone 60.000 btu per sallën e keshillit Bashkiak	375,000	202	2021	375,000	375,000		prokuruar ,proces likujdimi
	Kolaudim Punime ne rrugen e lagjes Vasku per eliminim rreshqitje ,fshati Hotolisht ,Nj.Adm.Hotolisht,Bashkia Librazhd.	2,040	2021	2021	2,040	2,040		Ne proces
	Mbikqyrje Permisimi i banesave ekzistuese per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuara	377,298	2021	2021	377,298	377,298		Ne proces
	Kolaudim Disiplinim I ujrave te bardha ne pjesen veriore te bibliotekes Librazhd	13,200	2021	2021	13,200	13,200		Ne proces
	Mbikqyrje "Punime ne rrugen e lagjes Vasku per eliminim rreshqitje fshati Hotolisht NJ.Adm.Hotolisht Bashkia Librazhd	16,800	2021	2021	16,800	16,800		Ne proces
	Kolaudim Izolimi i soletes se shkolles 9-vjecare Vilson blloshmi	2,640	2021	2021	2,640	2,640		Ne proces
	Kolaudim Ndertim shkolla 9-vjecare vartese Sebishte Nj.Adm Stebleve	6,000	2021	2021	6,000	6,000		Ne proces
	Kolaudim Rikonstruksion i kanalit vadites te Mesit,Gizavesh, Dorez, Librazhd	173,455	2021	2021	173,455	173,455		Ne proces
	Mbikqyrje Disiplinim I ujrave te bardha ne pjesen veriore te bibliotekes Librazhd	84,625	2021	2021	84,625	84,625		Ne proces
	Mbikqyrje Izolimi I soletes se shkolles 9-vjecare "V.Bllshmi"	16,475	2021	2021	16,475	16,475		Ne proces
	Detyrime te prapambetura	757,244			757,244	757,244		Ne proces
466							34,379,340	

Aparati i Bashkisë ka si objektiv formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës.

Për vitin 2021 në programin “ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes se objektivave të përcaktuara për vitin 2021, janë analizuar si më poshtë:

01. Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepileqtë). Është realizuar shpërblimi mujor në mënyrë sistematike dhe me korrektësi për anëtarët e këshillit bashkiak dhe kryepileqtë e njësive administrative.

02. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut.

Realizohet gjatë vitit transferimi dhe permbushja e detyrimit në bazë të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, e pa realizuar trashëguar në buxhetin e vitit 2022.

03. Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë Librazhdit në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësisë të Bashkisë së Librazhdit për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Kemi realizuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të administratës së Bashkisë Librazhd përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Mbështetje e strukturës funksionale me **119** punonjës . Plotësim sipas nevojës dhe rekrutimi i personelit të administratës vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës dhe në zbatimin e ligjeve:

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” të ndryshuar; VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”; i ndryshuar. Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore u bazua në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, datë 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.Realizuar rregullisht.

04. Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Librazhdit për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve

Ky aktivitet synon rekrutimin e burimeve profesionale për të qenë pjesë e administratës vendore përmes procedurave të përcaktuara me ligj, në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve. Këto rekrutime realizohen me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë realizohet përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Konkurimi ndjek disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të komisioneve të vlerësimit gjatë procesit të rekrutimit janë edhe punonjës të nivelit drejtues të administratës publike vendore si dhe ekspertë jashtë institucionit të Bashkisë Librazhd .

05. Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Librazhdit

Ky aktivitet synon që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryejnë trajnime në institucione të tjera trajnuese me iniciativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me

miratimin e titullarit të institucionit.

O6. Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Librazhd.

Është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Librazhd nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie etj. Realizuar me sukses në vazhdimësi .

O7. Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për administratën e Bashkisë së Librazhdit

Është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj për t'iu mundësuar punonjësve përmbushjen e detyrave administrative për të gjithë administratën.

Realizuar me sukses në vazhdimësi .

O8. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Librazhd.

Realizuar blerja e karburantit dhe furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Librazhd sipas nevojave në qendër , njësi administrative etj. Realizuar në vazhdimësi.

Realizuar shlyerja e pagesës së sigurimeve, taksave të qarkullimit dhe kolaudit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës .

O9. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre. Panairi i produkteve agroperpunuese sipas njësive administrative planifikuar për në muajin shtator “Festa e Mjaltit”.

Realizuar me sukses.

10. Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja

Organizimin e pritjeve përcjelljeve të delegacioneve përfaqësuesve dhe institucioneve vendase dhe të huaja me qëllim vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe me shumë institucione homologe të huaja, në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar .

O11. Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë.

Shërbimi për udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë është i domosdoshëm në rritjen e standartit të plotësisht të kushteve të punës ndaj administratës si dhe anasjelltas, në rritjen e eficiencës së administratës për dhënien e kontributit dhe përfaqësimin e duhur të institucionit në takime pune, seminare, workshop-e brenda dhe jashtë vendi . Për realizimin e këtyre lëvizjeve është bërë rimbursimi i shpenzimeve dhe dietave për administratën vendore në masën financiare që ligji e parashikon.

O12. Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Librazhd realizuar me sukses.

O13. Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Librazhdit.

Janë përmirësuar kushtet në zyrat administrative vendore.

O14. Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Librazhd.

Është realizuar në vazhdimësi ofrimi i shërbimit të internetit në të gjithë Bashkinë Librazhd dhe Njësitë Administrative .

O15. Mirëmbajtje Pajisje Informatike .Janë krijuar kushtet për mirëfunksionimin e pajisjeve TIK.

O16. Informimi i qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Librazhd.

O17. Mirëmbajtje e faqes zyrtare Web www.bashkialibrazhd.gov.al dhe moduleve të integruara të saj.

O18. Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Librazhd.

Realizuar në vazhdimësi shërbimi për regjistrimin e pronave të transferuara në pronësi të Bashkisë Librazhd , i cili synon përmbushjen e detyrimeve që Bashkia Librazhd ka për regjistrimin e pronave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Librazhd .

O19. Detyrime dhe kompensime legale. Realizuar në vazhdimësi .

Sektori Juridik ka përfaqësuar institucionin bashkinë Librazhd në procese gjyqësore civile, administrative , në të cilën ka qënë palë në proces.

Ka realizuar likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve, të cilat rrjedhin nga procese gjyqësore me vendim të formës së prerë, konkretisht 2 likuidime me vlerë totale 1,677 mijë lekë .

❖ NJËSIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Objektivat kryesore:

Objektiv 1

- Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrimit të parashikimeve për vitin 2021. Hedhja e të gjithë elementeve të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve Publike në sistemin elektronik të APP brenda afateve ligjore të parashikuara nga legjislacioni përkatës.

Objektiv 2

- Realizimin e të gjitha prokurimeve Publike të parashikuara në regjistër sipas afateve të përcaktuara.

Objektiv 3

- Përgatitja e shtesave dhe ndryshimeve të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve Publike gjatë vitit, hedhja në sistemin elektronik të APP.

Objektiv 4

- Nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës, së operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, duke përgatitur kriteret dhe dokumentat standarte të tenderit në përputhje me kërkesat ligjore.

Objektiv 5

- Bashkëpunimin mes zyrave të bashkisë për hartimin e specifikimeve, preventivave dhe kontrollit të tyre.

Objektiv 6.

- Asistenca ndaj komisionit të vlerësimit të ofertave, në rastet kur kërkohet nga vetë komisioni.

Objektiv 7

- Përgatitja e procedurës së prokurimit, duke filluar që nga urdhëri I prokurimit, përllogaritjen e fondit limit, hartimin dhe publikimin e njoftimeve për botim Brenda afateve ligjore, mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkalidhen dokumentave të tenderit (hartat, skicat, grafikun, planet etj).

Objektiv 8

- Realizimin e procedurave të Prokurimit publik nga organi qendror blerës Bashkia Librazhd për llogari të Institucioneve të Varesise së Bashkise në zbatim të urdherit të brendshëm të Titullarit të Bashkise.

Objektiv 9

- Kryerjen e inventarizimit të dosjeve të procedurave të prokurimit publik dhe dorëzimin e tyre në arkivin e Bashkisë.

Objektiv10

- Mirpërdorimin e fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve proceduriale.

Gjatë kësaj periudhe në Njësinë e prokurimit publik, është punuar për zhvillimin dhe realizimin e të gjitha procedurave të Prokurimit Publik të ardhura pranë zyrës së prokurimeve në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha drejtoritë përkatëse dhe dërgimin e tyre për likuidim pranë Drejtorisë së Finances dhe Degës së Thesarit brenda afateve ligjore, një bashkëpunim me Drejtorinë e Finances që ka realizuar mjaft i suksesshëm pasi nuk kemi pasur asnjë procedurë prokurimi që është refuzuar nga Drejtoria e Finances apo dhe Dega e Thesarit.

Në disa procedura prokurimi kemi patur ankesa nga operatorët ekonomik për kriteret apo për vlerësimin

nga komisioni i vlerësimit të ofertave, të gjitha keto të përkthyer në vonesa në kohe. Me hartimin e regjistrit të parashikimeve për vitin 2021, është bërë një përmiresim pasi jemi munduar të ulim sa më shumë numrin e procedurave të Prokurimit duke i bashkuar shumë prej tyre në një element të vetëm duke ulur në këtë mënyrë kostot për Autoritetin Kontraktor . Gjatë gjithë vitit kalendarik 2021, janë parashikuar si ze në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike rreth 77 procedura , nga të cilat 4(kater) procedura janë në vlerën nën 100 000 leke pa tvsh, për të cilat përjashtohen nga procedurat e prokurimit publik dhe vetëm deklarohen në Sistemin e Prokurimit Publik nëq realizohen nga Sektori i Finances. Një nga procedurat e prokurimit publik me objekt : “ Blerje mjete tip fouristrade 4x4 për administratën e Bashkisë Librazhd dhe automjet fouristrade 4x4 për Agjensinë e Pyjeve dhe Kullotave”, është inicuar në sistemin e prokurimit elektronik dhe me pas është anuluar kjo procedure e prokurimit publik me urdher të personit të autorizuar të Titullarit të AK, pasi Bashkia Librazhd ka nënshkruar me Fondacionin “ World Vizion Albania “, kontratë për dhurimin e pasurisë së luajtshme “ Automjet” me nr.7589 rep, nr.2430 kol, datë 10.09.2021.Për këtë arsye për kursim fondi është anuluar procedura e prokurimit publik.

Procedura prokurimi të realizuar në total që janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave perkatese janë 67 procedura të prokurimit publik në zhvilluar në Sistemin e Prokurimit Elektronik .

Procedura të cilat nuk janë ezuauruar me finalizimin e një kontrate publike (mallra, punë ose shërbim) janë 5(pese) procedura, citojme si më poshtë:

- “Rikonstrukcion i rrugëve rurale për vitin 2021, Proc.e II” me fond limit 7 344 181 leke pa tvsh. Kjo procedure prokurimit publik është proceduar në SPE pas miratimit të këtij objekti me vendim të Keshillit Bashkiak me nr.87, datë 29.10.2021 “ Për një ndryshim në Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.120, datë 29.12.2020 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit perfundimtar buxhetor afatmesëm 2021-2023 ”miratuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën me nr. 1209/1 prot, datë 05.11.2021. Ky objekt prokurimit aktualisht është në fazën e finalizimit të vlerësimit dhe është shpallur fituesi. Sipas Ligjit me nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “ Për prokurimin publik” dhe VKM me nr. 285 datë 19.05.2021 “ Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nën 85, Autoritetit Kontraktor ka afat deri në 60 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së fituesit për të nënshkruar dhe publikuar kontratën. Aktualisht jemi në fazën e nënshkrimit të kontratës.
- “ Blerje kamera sigurie për rrugët kryesore të qytetit”, me fond limit 3 816 408 leke pa tvsh. Për këtë ze të regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, është ngritur me urdher të Personit të Autorizuar të Titullarit të AK, grupi i punës për perlllogaritjen e vlerës së fondit limit, hartimin e preventivit, hartimin e specifikimeve teknike , grafikun dhe planin e realizimit të objektit. Deri më datë 31.12.2021 prane Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike nuk ka ardhur asnjë dosje teknike për të vijuar me tej procedurën e prokurimit publik.
- “ Studime Projektme për objekte të ndryshme ”, me fond limit 3 333 333 leke pa tvsh. Për këtë ze të regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, është ngritur me urdher të Personit të Autorizuar të Titullarit të AK, grupi i punës për perlllogaritjen e vlerës së fondit limit, hartimin e preventivit, hartimin e specifikimeve teknike , grafikun dhe planin e realizimit të objektit. Deri më datë 31.12.2021 prane Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike nuk ka ardhur asnjë dosje teknike për të vijuar me tej procedurën e prokurimit publik.
- “ Blerje materiale promovuese për turizimin ”, me fond limit 208 333 leke pa tvsh. Për këtë ze të

rregjistrit te parashikimeve te procedurave te prokurimit publik, eshte ngritur me urdher te Personit te Autorizuar te Titullarit te AK, grupi i punes per perlllogaritjen e vleres se fondit limit, hartimin e preventivit, hartimin e specifikimeve teknike , grafikun dhe planin e realizimit te objektit. Deri me date 31.12.2021 prane Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike nuk ka ardhur asnje dosje teknike per te vijuar me tej proceduren e prokurimit publik.

- “ Prerje , carje dhe transportin e druve te zjarrit ne shkollat e Njesive Administrative te Bashkise Librazhd ”, me fond limit 931 748 leke pa tvsh. Per kete ze te rregjistrit te parashikimeve te procedurave te prokurimit publik, nuk eshte percaktuar me urdher te Titullarit te AK apo te Personave te Autorizuar te Titullarit te AK , asnje grup pune per perlllogaritjen e vleres se fondit limit, hartimin e preventivit, hartimin e specifikimeve teknike , grafikun dhe planin e realizimit te objektit deri ne daten 31.12.2021.

Programi 01170- Gjendja Civile

Ky program përfshin zyrat e gjendjes civile në Bashkinë Librazhd dhe në 7 Njësi Administrative ,gjithësej 6 punonjës.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Qëllimi i programit 01170:

- Gjendja Civile është sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara.

Objektivi i programit është :

O1. Shërbime te deleguara të mbështetura për funksionimin e tyre.

Përshkrimi i programit

Fondet e pushtetit qëndror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Rezultatet e programit Gjendja Civile

000/leke					
Programi	Paga +	Shpenzime			
P01170	Sigurime	Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 2021	4,476		2,489		6,965
Realizimi 2021	4,469		2,489		6,958
	7		-		7
Diferencë	100%		100%		100%
Realizimi në %					

Realizimi i shpenzime për paga dhe sigurime është realizuar ne masën 100 %.

Transfertat janë aktet e pullave nga Gjendja civile në vlerën 1,134 mijë lekë, shpërblim lindje për regjistrim brenda afatit në vlerën 1,355 mijë lekë. .

Për vitin 2021 në programin 01170 “ Gjendja Civile ” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes se objektivave të përcaktuara është përmirësuar shërbimi i Gjendjes Civile.

O1.Shërbimet e deleguara Gjendja Civile

Është realizuar dhe përmirësuar rritja e të ardhurave të arkëtuara nga prodhimi i dokumentave dhe realizuar shkurtimi i kohës së marrjes së shërbimit.

FUNKSIONI : 03 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Nenfunksioni 031: Shërbimet policore

Programi 03140: Shërbimet e Policisë Vendore

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Policisë Bashkiake është:

Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të Bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore. Ky program ka gjithsej 8 punonjes .

- Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2021 kanë qënë:

O1. Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

O2. Sigurimi i Shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionimin e policisë.

Rezultatet e programit Shërbimet e Policisë Vendore

000/leke					
Programi P03140	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 2021	5,702	370			6,072
Realizimi 2021	4,912	-			4,912
Diferencë	790	370			1,160
Realizimi në %	86 %				80%

Realizimi i shpenzime për paga dhe sigurime është realizuar në masën 86 %.

Për vitin 2021 në Programin "Shërbimet Policore Vendore" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 4 aktivitete.

-Aktivitetet janë analizuar si më poshtë:

O1.Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë Librazhd për ofrimin e shërbimeve ndaj

qytetarëve.

O2. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake .

O3. Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë Bashkiake .

O4. Blerje rroba pune për punonjësit nuk është realizuar për shkak të refuzimit të mallit pasi nuk përmbushte specifikat e kërkuara

Nënfunksioni 032: Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri

Programi 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Sektorin e MZSH , gjithsej 15 punonjes.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit të Emergjencave Civile është:

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve,

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2021 kanë qenë:

O1. Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.

O2. Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.

O 3. Shërbim për sigurimin e transportit (blerje karburant).

O4. Shpenzime për mirmbajtjen për funksionimin e paisjeve të zyrës dhe paisjeve special.

O5. Sigurimi i jetës për zjarrfiksit.

O6. Blerje garderop dhe rroba pune .

Rezultatet e programit Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

					000/leke
Programi	Paga +	Shpenzime			
P03280	Sigurime	Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 2021	15,011	4,100		554	19,665
Realizimi 2021	13,024	1,966		554	15,544
Diferencë	1,987	2,134		0	4,121
Realizimi në %	88 %	48 %		100 %	79 %

Realizimi shpenzime për paga dhe sigurime është realizuar në masën 88 % sepse dy punonjës kanë qenë me raport mjeksor dhe një punonjës nuk ka qenë emëruar.

Shpenzimet operative janë realizuar në masën 48 %.

Investime janë realizuar 100%.

Realizimi total i këtij programi 79 %.

- ❖ Detajimi i shpenzimeve operative për programin “Mbrotjtja nga zjarri dhe mbrotjtja civile” 3280
Shpenzimet operative janë realizuar me 48 % kjo për shkak të disa kontratave të cilat nuk janë realizuar dhe konkretisht është :
- Blerje goma + pjesë xhenerike,mirëmbajtje mjeteesh ,nuk është realizuar pasi kontrata vazhdon edhe në 2022 .
 - Blerje materiale të # elektrike, hidraulike etj + shpenzime për mirëmbajtjen , funksionimin e paisjeve të zyrës dhe paisjeve speciale , nuk është realizuar.
 - Blerje rroba pune për punonjësit është refuzuar malli pasi nuk përmbushte specifikat e përcaktuara.
 - Blerje rafte për garderopen nuk është prokuruar.

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Kap	Plani vjetor	Shtesa	Pakësime	Plani me ndryshime 2021	Fakti 2021
1	Shpenzime për energjinë	1	300,000			300,000	112,297
2	Shpenzime për ujësjellësin	1	100,000			100,000	14,340
3	Udhëtime e dieta brenda vendit	1	200,000			200,000	-
4	Blerje karburant	1	1,000,000			1,000,000	999,918
5	Blerje goma + pjesë xhenerike,mirëmbajtje mjeteesh	1	500,000			500,000	-
6	Blerje materiale të # elektrike, hidraulike etj + shpenzime për mirëmbajtjen , funksionimin e paisjeve të zyrës dhe paisjeve speciale	1	300,000			300,000	-
7	Siguracion i jetës për zjarrfikësit	1	350,000			350,000	350,000
8	Siguracion makinash	1	100,000			100,000	90,000
9	Mbushje fikëset e zjarrit	1	100,000			100,000	99,600
10	Blerje materiale për mirëmbajtje paisjeve speciale (tuba zjarrfikëse)	1	300,000			300,000	300,000
11	Blerje rroba pune për punonjësit	1	600,000			600,000	-
12	Blerje rafte për garderopen	1	250,000			250,000	-
	Totali		4,100,000			4,100,000	1,966,155

03280	Sherbimi I mbrotjtjes ndaj zjarrit	554,500	554,500	
	Blerje pjese kembimi per mjetin Nisan Terrano AA308EO dhe riparim defekti te paparashikuar per mjetin Zjarrfikes tip Benz te MZSH Bashkia Librazhd	554,500	554,500	Perfunduar , likujduar

Për vitin 2021 në Programin "Mbrotjtja nga zjarri dhe mbrotjtja civile" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 3 aktivitete.

-Aktivitetet janë realizuar si me poshtë:

- O1. Përbalimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie .
- O2. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH .
- O3. Shërbimi i Mbrotjtjes nga zjarri dhe shpëtimi .

FUNKSIONI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE

Nënfunkcioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës.

Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmje tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve(Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme). Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Bashkia Librazhd gjatë vitit 2021 ne programin 04130 “Mbështetja për zhvillim ekonomik” ka qellim te programit te saj këto funksione zhvillimi:

- Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal.
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë.
- Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire .
- Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
- Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Objektivat për përmbushjen e ketyre funksioneve per vitin 2021 janë:

- O1. Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve ekonomike zhvillimore lokale.

O2. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

O3. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.

O4. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiar, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.

Rezultatet e programit 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik

					000/leke
Programi	Paga +	Shpenzime			
P04130	Sigurime	Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 2021	1,551	60	3,000		4,611
